

LIGJ
Nr.10 073, datë 9.2.2009

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE
VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, në nenin 27 pika 2, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfshirë për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksë e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6074, datë 27.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**